

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "Net-SFS Kreston Accounting" Sh.p.k.

Sot, me datë 18 / 01 /2018,

Z. Rezar Llukaçej, shtetas shqiptar, i biri i Selahedinit, lindur më 21.03.1977, në Shkodër, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 024501291, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Net-SFS Kreston Accounting" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Net-SFS Kreston Accounting" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Muhamet Gjollesha", Godina Qendra Tregtare Ring, Shkalla 2, Kati 6, Apartamenti 6, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Shërbime të kontabilitetit; Konsulencë fiskale, ligjore, ekonomike dhe financiare.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.



NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 3,000,000 Lekë (tre milion) dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Rezar Llukaçej**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 3,000,000 Lekë (tre milion) dhe 3,000,000 Lekë (tre milion) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Zj. Fatjeta Alushi**, shitetase shqiptare, e bija e Hasanit, lindur më 05.05.1984, në Shkodër, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit me nr. 030868717, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar. Administratori zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin **Zj. Fatjeta Alushi**, mbajtëse e Kartës së Identitetit me nr. 030868717, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

REZAR LLUKAÇEJ

Rezar Llukaçej

